

Syllabusi i lëndës

Lënda: AKAID I, *Bazat e Besimit Islam, doktrina e Ehli Sunetit.*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 109

Fondi i orëve: 2+2

Viti akademik: 2026/2027

Semestri: II

Mësimdhënësi: Prof. ass. Dr. Bahri Hoxha. Kontakti: e-maili: bhoxha9@live.com

Përshkrimi i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë ngërthen studimin e besimit në Shpalljen e Zotit, si kontakt fillestar me njeriun. Pozita e shpalljes përballë faktorëve të tjerë kognitiv në studimin e bazave të besimit islam. Njoftim i detajuar rreth përfaqësuesve shumicë të komunitetit muslimanë gjatë historisë, në paraqitjen, shpjegimin dhe argumentimin e besimit islam. Shkollat kryesore të besimit islam, doktrinat, metodologjia shkencore, ngjashmëritë dhe dallimet. Kontributi i ilm el kelamit në paraqitjen e saktë të besimit dhe demantimin e dyshimeve rreth parimeve besimore islame.

Qëllimi i lëndës

Njohja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Akaidit\Besimit Islam, parimet themelore siç është besimin në shpalljen hyjnore, pozitën e pejgamberëve dhe sinkronizimin adekuat të parimeve të vërteta fetare me parimet e shëndosha racionale. Zhvillimi i shkathësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e ndryshme mbi besimin të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse në tekstet themelore të besimit islam. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Akadi I semestrit të tretë, presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të detajuar mbi të besuarit e drejtë islam, të bazuar në argumente fetare dhe logjike. Të kuptojë qëndrimet e shkollave kryesore të Ehli Sunetit dhe të njohë metodologjinë e tyre të argumentimit. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj çështjet ndaj të cilave pati debate të shumta, që edhe ky të kontribuojë në këto pikëpamje. Të kuptojë se zhvillimi i studimit të besimit është në interes të ngritjes së

individit dhe shoqërisë në aspektin moral, sepse i kultivon njeriut humanizmin dhe e bën më të hapur dhe shpirtgjerë në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj mënyrën e besimit në parimet islame, si dhe të bëjë dallimin në mes autentikës dhe deformimit real në çështjet e besimit.

Të krahasojë ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme në çështjet e besimit, të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutojë rreth çështjeve të besimit islam në bazë të argumenteve esenciale islame, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbrojë qëndrimet e pikëpamjeve të ndryshme rreth bazave të fesë, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre nga Ehli Suneti dhe Xhemati.

Të prezantojë mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojë në relacionet shoqërore në vendin tonë.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, njohja me përmbajtjen e syllabusit. çështë lënda e Akaidit – Ilmul Kelami? Parimet dhe forma e studimit.

Literatura: **Mr. Naim Ternava**, *Shkenca e Ilmul Kelamit (parimet bazë)*, Prishtinë 2022. (Në vazhdim do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference).

Java e dytë: Relacioni: Shpallja, kuptimi, llojet dhe format e saj. Raporti i revelatws me mendjen.

Bisedë interaktive, rreth kuptimit të drejtë të shkencës së Kelamit.

Java e tretë: Shkenca e Kelamit ose Bazave të Fesë, historiku dhe përmbajtja. Emërtimet e shkencës së akidesë dhe tematikat e saj.

Java e katërt: Definim i terminologjisë së nevojshme shkencore për qasje në shkencën e Tevhidit. Nocionet: Selef, Halef, Ehlu Sunet, xhevher, arad, etj.

Ebu Hanifja dhe roli i tij në shkencën e Bazave të Fesë
Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Java e pestë: Shkollat kryesore akaidologjike të Ehli Sunetit dhe shfaqja e tyre.

Kuptimi i nocioneve: Shkollë - medhheb, fraksion, etj.

Java e gjashtë: Shkolla Maturidite e studimit të akidesë, zhvillimi, kontributi dhe përfaqësuesit kryesor.

Bisedë interaktive rreth njohurive të përgjithshme ndaj kësaj shkolle.

Java e shtatë: Doktrina e shkollës Maturidite, metodologjia dhe shtrirja.

Diskutim rreth doktrinës maturidite dhe metodologjisë së saj shkencore.

(Testi i parë).

Java e tetë: Shkolla Esharite e studimit të çështjeve akaidologjike, zhvillimi, kontributet dhe përfaqësuesit kryesor.

Diskutim rreth njohurive të përgjithshme ndaj kësaj shkolle.

Java e nëntë: Doktrina e shkollës Esharite, metodologjia dhe shtrirja.

Diskutim rreth doktrinës esharite dhe metodologjisë së saj shkencore – ngjashmëritë me shkollën maturidite.

Java e dhjetë: Shkolla hanbelite e studimit të çështjeve akaidologjike, shfaqjet e saj dhe përfaqësuesit kryesor.

Java e njëmbëdhjetë: Doktrina e shkollës hanbelite, metodologjia dhe shtrirja.

Bisedë interaktive rreth kuptimit të drejtë në mes shkollave akaidologjike.

Java e dymbëdhjetë: Temat kryesore që shkaktuan debat në mes dijetarëve të shkollave të akidesë.

Diskutim rreth kuptimit të drejtë të metodologjisë së shkollave.

Java e trembëdhjetë: Sifatet Haberije në mes të te'vilit dhe tefvidit.

Java e katërbëdhjetë: Njohje me Akiden e Tahaviut, ngjasimet dhe dallueshmëritë me shkollat akaidologjike.

Java e pesëmbëdhjetë: : Krahasim në mes shkollave të akides së Ehli Sunetit, ngjashmëritë dhe dallimet.

Bisedë interaktive rreth aplikimit të tematikave besimore në vendin tonë.

(Testi përfundimtar).

Literatura:

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. : **Mr. Naim Ternava**, *Shkenca e Ilmul Kelamit (parimet bazë)*, Prishtinë 2023.

Literartura shtesë dhe bibliografia:

1. *Pesë kryeveprat e Ebu Hanifes*, përktheu: Mustaf Bajrami, Prishtinë, 2000
2. **Kitabu't Tevhid**, Imam Maturidiu (perkth: Metin Izeti) 2018.
3. **Nyja e Besimit e Imam Tahaviut**, Vehbi S. Gavoçi 2015.
4. **Hyrje në bazat e besimit islam**, Nexhat Ibrahim, Prishtinë 2017.